




Microsoft e ka publikuar versionin e ri të paketës Windows Live Essential beta 2, i cili tashmë është në dispozicion për shkarkim.

Pakoja përmban programe falas të Windows, si Live Mail, Writer, Photo Gallery, Family Safety, Bing Toolbar, ndërsa programi më interesant në këtë mes është Windows Messenger i cili posedon edhe “chatin” e Facebook.

Ky është versioni i parë i Messenger i cili lejon edhe komunikimit përmes dritares së dialogut të cilën e ofron Facebook.

Përveç këtij opsioni të Facebook, Windows Messenger lejon edhe Facebook Feed, fotot dhe videot, ndërsa lejohet edhe postimi i statuseve apo fotografive në rrjetin social, përmes Messenger.

Tani, Windows Messenger është shndërruar në një vegël e cila luan rolin e klientit për rrjete sociale. Përveç Facebook, Messenger ka shtuar edhe sinkronizimin me MySpace.ipko/